

V E N D I M
Nr. 602, datë 2.11.2001

**PËR ÇMIMET TAVAN TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PËRDORUESIT
FAMILJARË DHE JOFAMILJARË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.7970, datë 20.7.1995 “Për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrit të Shtetit për Energjetikën, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çmimet tavan të shitjes së energjisë elektrike për përdoruesit familjarë, specialë dhe të tjerë të jenë sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pika 2 e vendimit nr.137, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave, vendimi nr.743, datë 18.12.1995 i Këshillit të Ministrave, vendimi nr.564, datë 23.10.2000 i Këshillit të Ministrave dhe vendimi nr.106, datë 2.3.2001 i Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

3. Ngarkohen Enti Rregullator i Energjisë, KESH sh.a., “Elektriku Elbasan” sh.a., “Elektriku Vlorë” sh.a. dhe “SESA Shkodër” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Nr.	EMËRTIMI	Çmimi
		lekë/kWh
A	Përdorues familjarë	
	300 kWh e para të muajit	4.0
	Mbi 300 kWh e para të muajit	8.0
B	Përdorues specialë	
	Furra buke	6.0
	Ujësjiellësa, objekte fetare	6.0
	Buxhetorët	8.0
	Nafta, kromi, bakri, siderurgjia, gjeologjia	8.0
C	Përdorues të tjerë	
	Furnizimi nga rrjeti TL (35 dhe 110 kV)	9.0
	Furnizimi nga rrjeti TM (6,10 dhe 20 kV)	10.0
	Furnizimi nga rrjeti TU	12.0

Shënim: Energjia e përdorur për mjediset e përbashkëta (ndriçim shkalle, ashensor, pompë uji) do të faturohet me 4 lekë.